

VENDIM
Nr. 265, datë 14.10.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DIMAX ALBANIA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1799/5 prot., datë 12.10.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Dimax Albania’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Dimax Albania” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1749 prot., datë 3.10.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Aplikuesi ka derdhur për llogari të ERE-s një shumë më të madhe se sa është përcaktuar në aneksin A të rregullores, ndaj pagesa shtesë do t’i kthehet në vijim.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Dimax Albania” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin, në zbatim të nenit 9, pikës 1.1, ghermat “a”, “b” dhe “c”; pikës 1.2, ghermat “a” dhe “d”; pikës 1.3, ghermat “b” dhe “c”; pikës 2.1, ghermat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni, si vijon:

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”:

- Germa “b”: Aplikuesi duhet të depozitojë vërtetimin për gjendjen gjyqësore (dëshmi penaliteti) për vetë shoqërisë “Dimax Albania” sh.p.k.

- Germa “c”: Shoqëria duhet të depozitojë informacion mbi funksionet që kryen çdo departament i strukturës organizative, në lidhje me veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”:

- Germa “a”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE, vërtetimin mbi shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve tatimore, i cili nuk duhet të jetë lëshuar më parë se 1 muaj nga paraqitja e aplikimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Dimax Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti